



BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 18-24 MUAJ **MUJAJI DHJETOR**



PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

 Fëmijët e Tiranës

<http://femijetetiranes.al/>

 femijet_e_tiranes

Kuriozitete për Muajin Dhjetor



Çfarë mund të dimë për Dhjetorin?

- * Muaji dhjetor është **muaji i parë i stinës** së dimrit, kur koha është **shumë e ftohtë** dhe në zonat malore bie borë.
- * Dhjetori është **muaji i fundit** i vitit.
- * Në dhjetor, **ditët janë shumë të shkurtra, ndërsa netët shumë të gjata** dhe të ftohta.
- * Frutat si: **mandarinat, portokallet, shegët, hurmat, gështenjat**, ne i shijojmë në stinën e dimrit.
- * Dhjetori është **muaji i festave të fundvitit** në mbarë botën.

Muaji Dhjetor

Tema: “Karakteristikat e Stinës së Dimrit dhe Përgatitja për Festat e Fundvitit”

Grupmosha 18-24 muaj

- **Java I:** Karakteristikat e stinës së dimrit.
- **Java II:** Njohja dhe shprehja e emocioneve përmes elementeve stinore.
- **Java III:** Njohja me Festat e Fundvitit dhe përgatitja e dekorit të festave.
- **Java IV:** Programi Festiv i Vitit të Ri.

Tema e Muajit: “Karakteristikat e Stinës së Dimrit dhe Përgatitja për Festat e Fundvitit”


Tema e Javës	Qëllimi	Koha
Karakteristikat e stinës së dimrit	Njohja me elementët stinorë të dimrit si: moti shumë i ftohtë, reshjet e shiut dhe borës, perimet e frutat e stinës.	Java I
Njohja dhe shprehja e emocioneve përmes elementeve stinore	Të përshkruajmë dhe njohim emocionet bazë, duke i ilustruar me frutat dhe perimet e stinës.	Java II
Njohja me Festat e Fundvitit dhe përgatitja e dekorit të festave	Njohim dhe krijojmë elementët dekorativë të Festave të Fundvitit, ngjyrat dhe format (pema, ylli, kubi, topi, etj).	Java III
Programi festiv i Vitit të Ri	Festojmë së bashku Festat e Fundvitit.	Java IV



- * Stafi edukator duhet të marrë pjesë në çdo aktivitet dhe temë ditore, bashkë me fëmijët.
 - * Stafi i praktikon aktivitetet në bazë të zhvillimit dhe interesave të fëmijëve.
 - * Stafi duhet të informojë prindërit mbi temën mujore dhe javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.
-


Tema e Muajit: "Karakteristikat e Stinës së Dimrit dhe Përgatitja për Festat e Fundvitit"

Tema e Javës: "Karakteristikat e stinës së dimrit"




Java I	Tema	Aktivitetet	Mjetet
E Hënë	Natyra në dimër 	<p>Bisedë: Edukatorja u tregon fëmijëve se në stinën e dimrit bën shumë ftohtë, bie shi/borë, pemët janë krejt të zhveshura dhe qielli është gri.</p> <p>Aktivitet: Vrojtojmë nga dritarja motin dhe edukatorja emërton elementët e natyrës si: retë, era, shiu, bora.</p> <p>Vjersha: "Shi shi".</p> <p>Lojë sensore: Improvizojmë borën Në një enë të madhe hedhim sodë buke dhe ujë. Fëmijët me ndihmën e edukatores e përziejnë masën derisa krijohet "bora".</p> <p>Aktivitet: Fëmijët me ndihmën e edukatores thërrmojnë një copë bukë peshku dhe e hedhin në ajër duke krijuar efektin/ndjesinë e borës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Sodë buke, • Ujë, • Pjatë ose enë (për t'i përzier), • Bukë peshku.


<p>E Martë</p>	<p>Njeriu prej bore</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u flet fëmijëve rreth borës, ngjyrën e saj, ku dhe kur bie më shumë borë.</p> <p>Vjersha: “Me borën, me borën”/ “Bie bora paf e puf”</p> <p>Vizatim: Vizatojmë dhe ngjyrosim njeriun prej bore.</p> <p>Aktivitet krijues: Marrim një jastëk dhe bashkë me fëmijët lidhim shallin te jastëku deri sa të krijohet koka. Më pas ngjyrosim kopsat/ letrat për të bërë sytë dhe gojën. Për hundën e njeriut prej bore vendosim një laps të vogël ngjyrë portokalli dhe në fund vendosim kapelen e Santës.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Jastëk/ këllëf jastëku, • Kapele Santa • Kopsa (letër adezive të zezë të prera në formë kopsë), • Ngjitëse, • Shall • Lapsa me ngjyra.
<p>E Mërkurë</p>	<p>Veshja e fëmijëve në dimër</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u shpjegon fëmijëve se si vishemi në dimër. Shpjegon, se për shkak të të ftohtit veshim rroba të trasha si xhup, shall, kapuç, doreza. Këto rroba na mbrojnë nga i ftohti.</p> <p>Vjersha: “Viu, viu, fryn veriu”.</p> <p>Punë dore: Përgatiten në fletë punë dore nga edukatorja, veshjet e stinës së dimrit për fëmijët. Fëmijët i ngjyrosin ato.</p> <p>Aktivitet krijues: Në një çarçaf edukatorja vizaton kapuç, shall, pantallona ose bluzë dhe më pas fëmijët me ndihmën e edukatores i presin me gërshërë dhe i ngjysin ato në një karton.</p> <p>Vjersha: “Muaji Dhjetor”.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Fleta punë dore, • Lapsa me ngjyra, • Çarçaf, • Gërshërë, • Ngjitëse.

<p>E Enjte</p>	<p>Veshja e kukullës</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u shpjegon fëmijëve se si e veshim kukullën në dimër dhe se cilat janë veshjet e duhura.</p> <p>Aktivitet: Edukatorja bashkë me fëmijët demonstron veshjen me elementët dimërorë, si: shalli, dorezat, kapelet, kapuçi, papuçet.</p> <p>Vjersha: “Muaji Dhjetor”.</p> <p>Lojë imituese: Fëmijët veshin kukullën me ndihmën e edukatores.</p>	
<p>E Premte</p>	<p>Përsëritja e aktiviteteve të javës</p>	<p>Bisedë: Përsëritja mbi elementët e mësuar gjatë javës.</p> <p>Vjersha: “Shi shi”/ “Me borën, me borën”/ “Viu, viu, fryn veriu”/ “Bie bora paf e puf”/ “Muaji Dhjetor”.</p> <p>Përrallë e lirë: Edukatorët ilustrojnë me anë të figurave (sipas librave që disponojnë në grup).</p>	

Temae Muajit: "Karakteristikat e Stinës së Dimrit dhe Përgatitja për Festat e Fundvitit"

Tema e Javës: "Njohja dhe shprehja e emocioneve përmes elementëve stinorë"



Java II	Tema	Aktivitetet	Mjetet
<p>E Hënë</p>	<p>Frutat e stinës dhe emocionet</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u shpjegon dhe u demonstroi fëmijëve përmes tablove dhe revistave frutat e stinës, si: molla, portokalli, mandarinat, shega, etj.</p> <p>Vjersha: "Etika e ushqimit".</p> <p>Loja\Aktivitet: Identifikimi i emocioneve me figura frutash të stinës së dimrit. Edukatorët mund të vizatojnë një fytyrë të qeshur dhe një të mërzitur në dy kokrra portokalle.</p> <p>Vizatimi/ Ngjyrosja: Frutat e stinës - ngjyrosja nga fëmijët e formave të përgatitura më parë nga edukatorët.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Fruta të printuara, • Gërshërë, • Letër, • Lapsa me ngjyra.



<p>E Martë</p>	<p>Perimet e stinës dhe emocionet</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u shpjegon dhe u demonstroi fëmijëve përmes tablove, librave perimet e stinës, si: lulëlakra, brokoli, thjerrëzat, spinaqi, karrotat, rrepat, etj.</p> <p>Vjersha: “Pemët dhe perimet”.</p> <p>Loja: Identifikimi i emocioneve me figura perimesh të stinës së dimrit.</p> <p>Vizatim/Ngjyrosje: Ngjyrosja e perimeve nga fëmijët, e formave të përgatitura më parë nga edukatorët, si: karrotat, panxhari, brokoli, lulëlakra, etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Perime të printuara, • Gërshërë, • Letër, • Lapsa me ngjyra.
<p>E Mërkurë</p>	<p>Përgatitja e ushqimeve në format e emocioneve</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u shpjegon fëmijëve përfitimet që kanë kur konsumojnë frutat dhe perimet, sa mirë i bëjnë trupit të tyre dhe sa të shijshme janë ato.</p> <p>Loja: Krijoni në pjata me anë të futave dhe perimeve emocione të ndryshme.</p> <p>Vjersha: “Karrota”.</p> <p>Përrallë: “Mbretëria e frutave” (ose një përrallë tjetër nga librat që keni në grup).</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Fruta të stinës, • Perime të stinës, • Pjata.





<p>E Enjte</p>	<p>Panairi i frutave dhe perimeve të stinës</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja pyet fëmijët: Cilat janë frutat dhe perimet e stinës? Çfarë ngjyre kanë ato? Çfarë ndieni kur hani fruta/perime?</p> <p>Aktivitet: Edukatorja u shpjegon fëmijëve që përdorimi i lëngjeve të ngrohta për stinën e dimrit ndihmon për të na mbrojtur nga i ftohti dhe gripi. Aktivitetet që mund të realizohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> * Mund të përgatitet nga kuzhina çaji dhe të serviret në grup. * Mund të përgatitet lëng me fruta të stinës nga kuzhinierja në prani të fëmijëve. <p>Panairi i frutave dhe perimeve: Edukatorët bashkëpunojnë me prindërit për të sjellë fruta dhe perime të stinës ose ëmbëlsira të përgatitura me fruta të stinës së dimrit (demonstrimi realizohet me konceptin e ngjyrës sipas kategorisë fruta/ perime).</p>	 
<p>E Premte</p>	<p>Punë dore me frutat dhe perimet e stinës</p> 	<p>Punë dore/ Punim me plastelinë: Të krijojmë fruta dhe perime të stinës së dimrit.</p> <p>Vizatim/ Ngjyrosje: Fëmijët vizatojnë me ndihmën e edukatores frutat dhe perimet që ata kanë më shumë qejf dhe i ngjyrosin ato.</p> <p>Përralla: “Kësulëkuqja”. (Edukatorja nxit fëmijët të tregojnë frutat dhe perimet në shportën e Kësulëkuqes me qëllim lidhjen e fruta-perimeve të stinës, të mësuara gjatë javës).</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Plastelinë, • Letra A4, • Lapsa/ bojtusha me ngjyrë, • Gërshërë. 

Tema e Muajit: "Karakteristikat e Stinës së Dimrit dhe Përgatitja për Festat e Fundvitit"

Tema e Javës: "Njohja me festat e fundvitit dhe përgatitja e dekorit"




Java III	Tema	Aktivitetet	Mjetet
<p>E Hënë</p>	<p>Elementët dekorues të festës së Vitit të Ri</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u tregon fëmijëve se dhjetori është muaji i fundit i vitit. Këtë muaj festojmë ardhjen e Vitit të Ri dhe me ardhjen e tij ne dekorojmë ambientet e ndryshme me: shirita shumëngjyrshë, yje, drita, etj.</p> <p>Vizatim/ Ngjyrosje: Ngjyrosja nga fëmijët e vizatimeve të Babagjyshit të Vitit të Ri, të përgatitura më parë nga edukatoret.</p> <p>Vjersha : “7 dhuratat”.</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Fleta A4, • Fleta adezive, • Kartona me ngjyra, • Lapsa/ bojtusha me ngjyrë, • Gërshërë.
<p>E Martë</p>	<p>Bredhi i Vitit të Ri</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u shpjegon fëmijëve se do të zbukurojnë bredhin, u tregon ngjyrat e elementëve dekorues dhe njëkohësisht i pyet: Çfarë ngjyre ka ylli, topi, bredhi, etj.?</p> <p>Aktivitet: Fëmijët së bashku me edukatoren zbukurojnë bredhin duke vendosur elementët dekorues festivë.</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”.</p>	




<p>E Mërkurë</p>	<p>Përgatitja e dhuratave</p> 	<p>Aktivitet: Edukatorja së bashku me fëmijët përgatisin dhurata, kuti të gatshme me përmasa të ndryshme i veshim me një paketim festiv. (Përdorim letra të shëndritshme dhe me ngjyra të ndryshme).</p> <p>Vjersha: “7 dhuratat”.</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi viti i Ri”.</p>	
<p>E Enjte</p>	<p>Përgatitja e kapeleve të Viti të Ri</p> 	<p>Aktivitet: Edukatorët të bashkëpunojnë me prindërit për të sjellë kapele festive për Vitin e Ri për fëmijën e tyre.</p> <p>Vizatim/ Ngjyrosje: Fëmijët së bashku me edukatoren të vizatojnë në kartona kapelet, më pas t’i presin në formën e dhënë dhe pastaj t’i dekorojnë/ ngjisin një ose disa elementë festivë.</p> <p>Vjersha: “7 dhuratat”.</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”.</p>	
<p>E Premte</p>	<p>Përgatitja e kartolinave të urimit</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u shpjegon fëmijëve se do të përgatisin së bashku kartolinat për Vitin e Ri dhe u demonstron një kartolinë.</p> <p>Aktivitet: Fëmijët së bashku me edukatorët vizatojnë, ngjyrosin, presin kartolinën dhe ngjisin një ose disa elementë festivë.</p> <p>Vjersha: “7 dhuratat”.</p> <p>Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri”.</p>	

Tema e Muajit: "Karakteristikat e Stinës së Dimrit dhe Përgatitja për Festat e Fundvitit"

Tema e Javës: "Programi Festiv i Vitit të Ri"



Java IV	Tema	Aktivitetet	Mjetet
<p>E Hënë</p>	<p>Dekorimi i mjediseve në grupe</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja u shpjegon fëmijëve se festa po afron dhe të gjithë së bashku do të festojnë me vjersha dhe këngë Vitin e Ri. Edukatorja së bashku me fëmijët përgatisin vargje me punë dore për zbukurimin e mjedisit në grup, vendosin pambuk në dritare, pemë dhe yje të përgatitura me punë dore.</p> <p>Vjersha: "7 Dhuratat"</p> <p>Vjersha: "Vjersha për stinën e dimrit"</p> <p>Vjersha: "Bora e bardhë",</p> <p>Vjersha: "Viu, viu, fryn veriu"</p> <p>Kënga: "Ja na erdhi Viti i Ri"</p> <p>Vjersha/këngë të mësuara gjatë vitit në programin edukativ.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Letra me ngjyra, • shirita, • Manuali i këngëve dhe vjershave.

<p>E Martë</p>	<p>Përgatitja e vjershave dhe këngëve</p> 	<p>Aktivitet festiv në grup: Edukatorja bashkë me fëmijët përgatisin në grupe programin festiv.</p> <p>Vjersha: “7 Dhuratat” Vjersha: “Vjersha për stinën e dimrit” Vjersha: “Bora e bardhë” Vjersha: “Viu, viu, fryn veriu” Kënga: “Ja na erdhi Viti i Ri” Vjersha/këngë të mësuara gjatë vitit në programin edukativ.</p>	
<p>E Mërkurë</p>	<p>Përgatitja e vjershave dhe këngëve</p> 	<p>Aktivitet festiv në grup: Edukatorja bashkë me fëmijët përgatisin në grupe programin festiv.</p> <p>Vjersha: “7 Dhuratat” Vjersha: “Vjersha për stinën e dimrit” Vjersha: “Bora e bardhë” Vjersha: “Viu viu fryn veriu” Kënga: “Ja na erdhi viti i Ri” Vjersha/ këngë të mësuara gjatë vitit në programin edukativ.</p>	
<p>E Enjte</p>	<p>Përsëritja e vjershave dhe këngëve</p>	<p>Përsëritje e programit festiv. Bisedë me prindërit: -Veshja festive e fëmijës për festën e Vitit të Ri (përgatitje për festën e ditës së nesërme) - Dhurata që prindi dëshiron të sjellë për fëmijën .</p>	
<p>E Premte</p>	<p>Festa e Vitit të Ri</p> 	<p>Realizimi i programit festiv.</p> <p>Shpërndarja e dhuratave.</p>	